

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.M., nga Gjakova, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.792/2015, datë 25.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 15.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e papabuar ankesa e të akuzuarit E.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.792/15, datë 25.11.2016, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr.792/15, datë 25.11.2016, të akuzuarin E.M., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 400 € (katërqind euro), të cilën dënim është detyruar që të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 € (njëzetë) ditësh duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20 € (njëzetë euro), të gjobës, I akuzuari është detyruar që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjakovë, kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari E.M. , dhe atë vetë për shkak vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lenden ta kthej në rishqyrtim.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr. 369/2017, datë 24.03.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Edhe pse në petitumin e ankesës i akuzuari e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin nga përmbajtja e ankesës del se ai e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike duke theksue se unë asnjë herë nuk e kamë keqpërdor energjinë elektrike në mënyr të jashtligjëshme dhe se për këtë arsye nuk pranoj ti vuaj pasojat, andaj duke u bazuar në atë që u tha më lart këtë aktgjykim e kundërshtoj në tersi dhe kërkoj të rishqyrtohet edhe një herë rasti im meqenëse është specifik si dhe duke u bazuar në rrethanat ekonomike është pothuajse i paararishëm.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të të akuzuarit , nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari , ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës në pa mëdyshje gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar nga procesverbali me numër 0215610, të datës 29.01.2014 të lëshuar nga Keds –Disktrikti në Gjakovë, fatura me numër 62/14 të datës 06.02.2014 të lëshuar nga Keds-Distrikti në Gjakovë, nga fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJ14HPO3543 të datës 07.02.2014 të lëshuar nga Keds-Distrikti në Gjakovë, nga fotodokumentacioni që është pjesë e lëndës, , nga deklaratat e dëshmitarve K.I. dhe D.M., të dhënë në shyrtrimin gjyqësor si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit E.M., në pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se i akuzuari ka krye veprën penale në vende kohë dhe mënyr si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, për ç’ka me të drejtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë të akuzuarin e lartcekur e ka shpallur fajtor. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe kjo gjykatë.

Kolegji i kësaj gjykate , ka ardhur në përfundim se nuk është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit, se vepra penale për të cilën ndiqet i akuzuari përbën vepër penale, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, nuk ekzistojnë rrethana që

përrjashtojnë ndjekjen penale, se është zbatuar ligji i aplikueshëm. Meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se drejtë është aplikuar edhe ligji penal kundër të akuzuarit kur është shpallur fajtor për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar

Sa i përket vendimit për dënim, i akuzuari me ankesë pretendon se për shkak të rrethanave dhe në bazë të deklaratës sime të dhënë në Gjykatën Themelore në Gjakovë shihet qartë se ai për asnjë moment nuk e ka keqpërdorur energjinë elektrike në mënyrë të jashtëligjshme dhe për këtë arsye i akuzuari thekson se nuk e pranon të vuaj pasojat, andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë i akuzuari e kundërshton aktgjykimin dhe kërkon që rishqyrtohet rasti duke u bazuar në rrethanat ekonomike është pothuajse i pa arritshëm, duke u nisur nga fakti se i akuzuari jeton me një burim të ardhurave disa anëtar të familjes dhe duke u nisur nga gjendja e dobët ekonomike i akuzuari lut gjykatën të bëjë edhe një herë shqyrtimin e çështjes së tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të të akuzuarit për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar në atë mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana rënduese pati parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, rrethanat në të cilat është kryer vepra, ndërsa si rrethana lehtësuese mori sjelljet e tij para kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së saj, mos dënueshme rinë e tij të mëparshme, të gjitha këto rrethana ndikuan që gjykata e shkallës së parë të zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të ndikonin në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.364 /17, datë 15.05.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani

Gani Zabeli